Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

# Lista Përfundimtare e Votuesve- Ferizaj

# 2012

Prishtinë, Prill, 2012

## Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (ligji numër 03/L-073), neni 64.2. KQZ- ja është përgjegjëse që të *çertifikoj listën e votuesve* në raport me zgjedhjet e caktuara. Ky dokument e mbështetë procesin e çertifikimit të listës së votuesve.

## Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve **(LPV 2012)** për Zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Ferizajit 2012 bazohet në Ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lista Përfundimtare e Votuesve- 2012 për Komunën e Ferizajit përmban 95449 emra të votuesve. Me një rritje të votuesve të rinj prej 4744 apo 4,9% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është 25 (ashtu siç ka qenë edhe ne zgjedhjet e kaluara), ndërsa numri i vendvotimeve është 124, me një rritje prej 2 vendvotimeve nga zgjedhjet e kaluara.

## Përshkrim

Pas pranimit të ekstraktit të Regjistrit Civil[1], ekipi i Shërbimit të Votuesve para se të fillojë alokimin e votuesve në QV ka marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen e Listës së Votuesve. Afatet kohore shumë të ngjeshura dhe të shkurtra kanë ndikuar në përshpejtimin e procesit të krijimit të listës së votuesve.

Aktivitetet për përgatitjen e Listës së votuesve 2012 kanë vazhduar me caktimin e votuesve të rinj në QV në mënyrë automatike dhe manuale ( Votuesit e vjetër që kanë votuar në mënyrë të rregullt në Qendrat e tyre të votimit nuk janë prekur).

Në vazhdim është bërë caktimi automatik, ndërsa votuesit të cilët nuk kemi mundur t'i caktojmë automatikisht, listat janë dërguar në terren për caktim në mënyrë manuale nga Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-së së Komunës së Ferizajit.

Gjithashtu janë inkorporua ndërrimet e adresave nga zgjedhjet e kaluara. Këta votues janë caktuar në qendra të reja të votimit duke u bazuar në adresën e tyre të re.

[1] Agjensia e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Rrjedhimisht, sipas këtij vlerësimi numri i përgjithshëm i kartolinave që iu kanë dërguar votuesve për t'ju konfirmuar qendrën e votimit është **8242** Kartolina dhe Letra individuale.

Pas një caktimi fillestar të votuesve, kanë pasuar dy periudha të rishikimeve të Listës së Votuesve nga ana e publikut:

**Periudha e shërbimit të votuesve**

Të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që të kontaktojnë zyrtarin ekzekutiv komunal (04.04 – 08.04.2012) për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe 296 votues kanë vizituar Zyrët e KKZ-ve, 81 votues kanë kërkuar ndërrimin e QV, ndërsa 215 e kanë konfirmuar QV-në.

Votuesit vazhdimisht kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit në ëebfaqen e KQZ-së.

Pas kësaj periudhe, zyra për shërbim të votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve e cila më pas është integruar në ekstraktin e 2 të pranuar nga ARC-ja.

Bazuar në këto të dhëna, zyra për shërbimin e votuesve ka krijuar listën e përkohshme të votuesve (LPV). LPV-ja ka qenë prezantimi i parë publik i listës së votuesve e cila do të përdoret për këto zgjedhje.

Ky dokument i është dërguar KKZ-së dhe ka qenë i postuar në faqen e internetit të KQZ-së. Gjithashtu, CD me kopje të LPV-së kanë qenë të përgatitura dhe i janë shpërndarë subjekteve politike dhe kanë qenë në dispozicion të vëzhguesve.

**Periudha e kundërshtimit dhe Konfirmimit**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit (12.04 – 16.04.2012 ) i ka mundësuar të gjithë votuesve që të konfirmojnë dhe kundërshtojnë LPV-në. Pas periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, zyra e Shërbimit të Votuesve nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatës Komunale.

**Krijimi i LPV-së**

Pas gjithë këtyre fazave dhe pranimit të ekstraktit të tretë të regjistrit Civil, Zyra për Shërbim të Votuesve i ka klasifikuar votuesit nëpër QV, si dhe i ka ndarë në vendvotime sipas alfabetit. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e zyrës për Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëj shtypjen përfundimtare të LPV-së 2012.

**Votimi përmes Postës**

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes 04.04.- 09.04.2012 ashtu siq përcaktohet me rregullën Nr.15 të KQZ mbi zgjedhjet e parakohshme/jashtëzakonshme dhe vendimin e KQZ-së. Njësia e Shërbimit të votuesve ka dërguar 319 formular dhe të gjitha materialet e nevojshme informuese votuesve të zgjedhjeve të kaluara në 23 shtete të Botës. Po ashtu Formular për regjistrim dhe materiale informuese janë dërguar edhe tek 50 pikat shpërndarëse në 23 shtete. Informatat e nevojshme dhe formulari janë publikuar në webfaqen zyrtare të KQZ-së.

Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit nuk kemi pranuar asnjë aplikacion. Rrjedhimisht nuk kemi pasur asnjë votues për votim përmes postës.

**Përmbledhje në lidhje me Listën e Votuesve- Ferizaj 2012**

| Nr | Kategoria | Numri i përgjithshëm | Koment |
|---|---|---|---|
| 1 | Numri i përgjithshëm në Listë Përfundimtare të Votuesve | 95449 | |
| 2 | Votuesit e rinj | 4744 | Votues që mbushin 18 vjetë – **2960** |
| 3 | Votues që kanë ndryshuar adresë brenda Ferizajit | 3917 | Prej tyre **1130** votuesve ju ka përmirësuar P-codi por Qendra e Votimit i ka mbet e njëjtë. |
| 4 | Votuesit që kanë ndryshuar adresë në nivel të Kosovës dhe janë kthyer në Ferizaj | 710 | Në zgjedhjet e kaluara kanë qenë pjesë e komunave tjera. |
| 5 | Votues të larguar nga LV-ja si të vdekur, humbur shtetësinë apo kanë kaluar në komuna tjera | 1632 | |
| 6 | Votues të larguar nga LV-ja si të vdekur me Vendim të KQZ-së sipas bazës së Gjendjes Civile | 249 | Vazhdojnë të mbesin në Regjistër Civil |
| 7 | Kartolina dhe Letra informuese për votuesit e rinj dhe atyre që kanë ndryshuar adresë | 8242 | |

**Përmbledhje:**

1. **Numri i votuesve në Komun dhe Numri i Qendrave të Votimit dhe i Vendvotime**

| Komuna | Numri i Votuesve | Numri i QV | Numri i VV |
|---|---|---|---|
| 25 – Ferizaj/Uroševac | 95449 | 25 | 124 |

**Rekomandime për Agjencionin e Regjistrimit Civil dhe KQZ-në**

Njësia e Shërbimit të Votuesve është e kënaqur dhe e vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe professional me Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me krijimin e Listës së Votuesve.

Përfundimisht krijimi i Listës së Votuesve në bazë të Regjistrit Qendror Civil ka kaluar nëpër një proces të detajuar të shqyrtimit dhe analizimit në mënyrë profesionale dhe në konsultim të vazhdueshëm me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Megjithëse ka një përparim të të dhënave në Regjistrin Civil dhe po ashtu Lista e Votuesve të Komunës së Ferizajit i reflekton këto përparime, këtu reflektohet edhe puna e grupeve punuese KQZ-MPB për të zbatuar strategjinë e KQZ-së për përmirësimin e Listës së Votuesve.

Megjithëkëtë, procesi i marrjes së letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës është duke e dëmtuar edhe më shumë një aspekt të të dhënave të Regjistrit Civil dhe rrjedhimisht do të reflektohet edhe në Listën e Votuesve. Fjala është për qytetet e mëdha të cilat posedojnë më shumë se një P-cod për qendrën urbane ( disa UD-code), ndërsa administrata e Qendrave Komunale të Regjistrimit Civil gjatë aplikimit për letërnjoftime apo dokumente të udhëtimit nuk po ju vendosë p-codin e saktë të pjesës (lagjes) së qytetit, por po ja vendosë vetëm p-codin gjeneral të qytetit. Si pasojë KQZ-ja të gjithë qytetarëve që ju ka ndryshuar p-codi do të ju ndryshojë edhe Qendrën e Votimit. Kjo reflektohet edhe në Listën e Votuesve të komunës së Ferizajit dhe do të reflektohet edhe shumë gjatë zgjedhjeve në nivel Shteti.
Lidhur me proceset e ardhëshme të krijimit të Listës së Votuesve ofrojmë këto rekomandime:

- Të vazhdohet me pastrimin e Regjistrit Civil nga emrat e personave të vdekur
- Ngritjen e cilësisë së adresave të votuesve, respektivisht krijimi i sistemit të adresave.
- Shqyrtimin dhe përmirësimin e P-kodeve të të regjistruarëve dhe vendosjen e P-codeve (UD-codeve) të sakta.
- Digjitalizimi i futjes së të dhënave gjatë lajmërimit të faktit të vdekjes.
- Zbatimi i Strategjisë së KQz-së për përmirësimin e Listës së Votuesve.